

VENDIM
Nr. 104, datë 23.5.2025

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1496/1 prot., datë 21.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. ka paraqitur në ERE kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike më 10.4.2025 dhe më pas, më 15.4.2025, ka dorëzuar mandatin e pagesës, duke shënuar fillimin e llogaritjes së afatit të shqyrtimit të aplikimit.

2. Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 24.4.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Në datat 25.4.2025 dhe 26.4.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit.

- Deri më datë 5.5.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë pasur të tilla.

3. Kërkesa për dokumentacionin plotësues

- ERE me shkresën nr. 1496/4 prot., datë 30.4.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim.

4. Dorëzimi dhe vlerësimi i dokumentacionit plotësues

- Më 5.5.2025, shoqëria dorëzoi në ERE dokumentacion shtesë për aplikimin, si në mënyrë elektronike ashtu edhe fizike. Pas shqyrtimit, ERE kërkoi sqarime dhe dokumentacion shtesë për mbështetjen financiare dhe planin e biznesit. Në përgjigje, më 19.5.2025, shoqëria dorëzoi planin e biznesit të përditësuar dhe kërkoi disa ditë shtesë për dorëzimin e dokumentacionit financiar.

5. Shtyrja e afatit të vendimarrjes

- Referuar nenit 14, pika 3 të rregullores, Bordi i ERE-s mund të zgjatë afatin e vendimarrjes deri në 30 ditë, kur dokumentacioni nuk është i plotë.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë dhe të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e kësaj shoqërie për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti